

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

RAPORTI I KOMISIONIT PROFESIONAL-SHKENCOR PËR ZBATIMIN E PROCEDURËS SË ZGJEDHJES SË BASHKËPUNËTORIT SHKENCOR PËR TEKSTET SHKOLLORE DHE MJETET MËSIMORE NË INSTITUTIN PEDAGOGJIK TË KOSOVËS

Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 14.03.2013, nenit 48, të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, Rregullores nr.55/24, të datës 12.09.2024, për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencorë dhe Hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, Ligjit të Punës nr. 03/L212, vendimit nr. 67/24. të datës 13.11.2024 Këshilli Shkencor i Institutit ka shpallur konkurs për një pozitë: **Bashkëpunëtor shkencor për tekstet shkollore dhe mjetet mësimore.**

Komisioni, pasi e ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur në konkurs, i paraqet Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës vlerësimin profesional-shkencor për kandidaten e paraqitur për pozitën **Bashkëpunëtor shkencore për tekstet shkollore dhe mjetet mësimore.**

VLERËSIMI PROFESIONAL DHE SHKENCOR

Duke u mbështetur në dokumentacionin dhe dosjen e dorëzuar nga kandidatja, komisioni vërteton se në konkursin e shpallur më datën 13. 11. 2024, në Faqen Zyrtare të Institutit Pedagogjik të Kosovës, për pozitën e **Bashkëpunëtores shkencore për tekstet shkollore dhe mjetet mësimore** të Institutit Pedagogjik të Kosovës, ka konkurruar vetëm një (1) kandidat: Safete Shala, nr. protokollit 68/24.

Komisioni, pasi e verifikoi dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatja, ka konstatuar se ajo i plotëson kushtet formale juridike për t'iu nënshtruar procedurave të përzgjedhjes për pozitën

Bashkëpunëtorë shkencorë për tekstet shkollore dhe mjetet mësimore. Komisioni me kujdes e ka shqyrtuar dosjen dhe në bazë të kriterëve të shpallura në konkurs i ka shqyrtuar thirrjet shkencore, përvojën e punës, të arriturat profesionale shkencore, projektet e kandidatës për zhvillimin e punës profesionale-shkencore të Institutit Pedagogjik të Kosovës, andaj Komisioni i ka paraqitur të dhënat biografike dhe bibliografike për kandidaten, sipas datës dhe nr. të protokollit:

1. **Dr. Safete Shala** u lind më 23.08.1965 në Batllavë – Podujevë. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, në Batllavë, ndërsa gjimnazin "8 Nëntori" në Podujevë. Studimet themelore i mbaroi në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Filologjisë, në vitin 1991. Studimet e nivelit master i mbaroi në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Filologjisë, në vitin 2012. Në vitin 2023 ka përfunduar studimet e Doktoratës në Universitetin e Sofjes "Sv. Kliment Ohridski", Fakulteti i Filologjisë Sllave, në Bullgari, dhe ka marrë titullin doktore e shkencave të filologjisë. Diploma është nostrifikuar nga MASHT-i, e dëshmuar me vendimin e nostrifikimit nr. 2/6-326. Nuk ka ofruar dëshmi lidhur me përvojën në udhëheqje arsimore.

Lidhur me përvojën kërkimore-shkencore, kandidatja ka ofruar dëshmi për një (1) publikim në revista të indeksuara në Scopus. Gjithashtu, ka ofruar dëshmi të punës kërkimore-shkencore në Institutin Pedagogjik të Kosovës. Ka botuar tri (3) libra dhe dhjetëra punime në revistën e IPK-së "Kërkime Pedagogjike". Për çështjet e përvojës në veprimtarinë profesionale/zhvillimore ka prezantuar kontributin në zhvillimin e politikave arsimore, hulumtimet në arsim, si dhe e trajnimin e mësimdhënësve.

Mbështetur në të dhënat e prezantuara të kandidatës, e cila është paraqitur për pozitën e zgjedhjes **Bashkëpunëtorë shkencorë për tekstet shkollorë dhe mjetet mësimore** në Institutin Pedagogjik të Kosovës dhe duke iu referuar Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, Rrregullores nr. 55/24, të datës 12.09.2024, për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencorë dhe Hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, Komisioni ka përgatitur këtë raport për Këshillin Shkencor të Institutit.

Duke u mbështetur në rezultatet dhe të arriturat e punës profesionale dhe shkencore, përgatitjen adekuate për pozitën e kërkuar në konkurs, punimet shkencore të botuara në revistat shkencore relevante, pjesëmarrjen në aktivitete profesionale, konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, projektet shkencore, kontributet shkencore, përvojën menaxheriale, paraqitjen e projektit për udhëheqjen e Institutit Pedagogjik të Kosovës, përvojën e punës, përvojën e dëshmuar në projektet profesionale-shkencore të kërkuara me konkurs, komisioni për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes propozon që kandidatja, **dr. Safete Shala**, i plotëson kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta, të kërkuara në konkurs, për pozitën **Bashkëpunëtorë shkencorë për tekstet shkollorë dhe mjetet mësimore**.


PËRFUNDIM

Në bazë të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr. 04/L-135, të datës 28.03.2013, Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës, nr.55/24, të datës 12.09.2024; si dhe bazuar në të arriturat profesionale dhe shkencore, komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes njëzëri i propozon Këshillit Shkencor të Institutit Pedagogjik të Kosovës kandidaten **dr. Safete Shala**, për pozitën **Bashkëpunëtorë shkencorë për tekstet shkollorë dhe mjetet mësimore**, në Institutin Pedagogjik të Kosovës, meqë i plotëson kushtet e përzgjedhjes.


Prishtinë, 10.12.2024

Komisioni profesional-shkencor

1. Prof. dr. Begzad Baliu (kryetar)



2. Dr. Tringa Dedi, IPK (anëtare)



3. Prof. asoc. dr. Majlinda Gjelaç (anëtare)

